REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 42/17
Date/Datum. 30.03.2017
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

PSH. nr. 42/17

PANELI SHQYRTUES I PROKURIMIT PUBLIK i emëruar nga kryetari në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2 si dhe nenit 106 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, si dhe nenit 28 paragrafi 1 të Rregullores se Punës së OSHP-së, në përbërje Tefik Sylejmani –Kryetar, Ekrem Salihu -Referues dhe Nuhi Paçarizi -Anëtar, duke vendosur sipas ankesës me nr. të protokollit 42/17, të parashtruar nga operatori ekonomik "ALBKOS INT" N.T.SH. me seli në Fushë Kosovë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Servisimi-mirëmbajtja e aparaturave kundër zjarrit", me nr. të prokurimit 634/16/073/221, të shpallur nga autoriteti kontraktues– Komuna e Klinës, në seancën e dt. 22 mars 2017, mori këtë

V E N D I M

I. **Aprovohet** , si pjesërisht e bazuar ankesa e operatorit ekonomik "ALBKOS INT" N.T.SH. me seli në Fushë Kosovë, me nr. të protokollit 42/17, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Servisimi-mirëmbajtja e aparaturave kundër zjarrit", me nr. të prokurimit 634/16/073/221, të shpallur nga autoriteti kontraktues– Komuna e Klinës.

II. **Anulohet,** vendimi i autoritetit kontraktues Komunës s Klinës, njoftim për dhënie të kontratës për aktivitetin e prokurimit me titull: "Servisimi-mirëmbajtja e aparaturave kundër zjarrit", me nr. të prokurimit 634/16/073/221, dhe nëse autoriteti kontraktues ka ende interes për zhvillim të këtij aktiviteti të prokurimit lenden ta kthej ne Ri-tenderim, duke bërë përmirësimet e dosjes së tenderit në mënyrë që të ofroj pjesëmarrje me të gjerë të operatorëve ekonomik.

III. Autoriteti Kontraktues në aftë prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me ketë prokurim .

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin Shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të LPP-së nr. 04/L-042, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues , që nuk respekton vendimin e Panelit Shqyrtues të paraparë me ketë ligj.

V. Operatorit ekonomik ankues **"ALBKOS INT" N.T.SH.** me seli në Fushë Kosovë, konform nenit 118 pika 3, i'u kthehen tarifa e sigurimit të ankesës.

VI. Urdhërohen, operatoret ekonomik ankues që konform nenit 36 pika 5 të Rregullores së Punës të OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Autoriteti Kontraktues–Komuna e Klinës, më dt. 17 nëntor 2016, ka publikuar *Njoftim për kontratë* lidhur me aktivitetin e prokurimit **"Servisimi-mirëmbajtja e aparaturave kundër zjarrit"**, me nr. të prokurimit 634/16/073/221.

Si kriter për dhënie të kontratës ka qenë Tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët.

Për këtë aktivitet të prokurimit kanë ofertuar 3 (tre) operator ekonomik, ku sipas komisionit vlerësues pranë autoritetit kontraktues të gjithë operatoret ekonomik i kanë plotësuar kriteret e përzgjedhjes të kërkuara në FTD dhe në njoftimin për kontratë.

Autoriteti kontraktues, më dt. 30 janar 2017, ka publikuar njoftimi për dhënie të kontratës.

Kundër vendimit për refuzimi të kërkesës për rishqyrtim, të dt. 02 shkurt 2017, operatori ekonomik ankues **"ALBKOS INT" N.T.SH.** me seli në Fushë Kosovë, në afatin e paraparë ligjor kanë parashtruar ankesë në OSHP-ë.

Pikat e ankesës:

Operatori ekonomik ankues **"ALBKOS INT" N.T.SH.** me seli në Fushë Kosovë, pretendon se autoriteti kontraktues Komuna e Klinës, gjatë procesit të vlerësimit të ofertave ka bërë shkelje te nenit 1, nenit 6, nenit 7, nenit 10, nenit 59, nenit 61 të LPP-së, UA 03/2015, UA 02/2015, si dhe shkelje e paragrafit 30.1 të dosjes së tenderit, ku në kriteret për dhënie të kontratës është precizuar tenderi i përgjegjshëm Çmimi me i ulët sipas kritereve: Servisim i rregullt pesha 40%, Mbushja e aparateve 30%, Pjesët dhe furnizimi 30%.

Ankesa e operatorit ekonomik është e afatëshme dhe është parashtruar nga ana e personit kompetent.

Ankesa është pjesërisht e bazuar.

Organi Shqyrtues i Prokurimit pas pranimit të ankesës, në bazë të nenit 113 dhe 114 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, me datën 15 shkurt 2017, ka autorizuar eksperten shqyrtues, për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Ekspertja shqyrtues, me dt. 27 shkurt 2017, i dorëzon panelit shqyrtues raportin e ekspertizës, ku në raportin lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues ku thuhet se autoriteti kontraktues ka bërë shkelje të nenit 10 të LPP-së, bazuar ne shkresat e lëndës sqaron se operatori ekonomik ankues përmes shkresës elektronike (e-malit) të dt. 31 janar 2017, adresuar autoritetit kontraktues ka theksuar: nuk pajtohemi me këtë vendim tuja sepse nuk keni marrë për bazë kërkesën tonë për rishqyrtim përkatësisht nuk keni marrë për bazë fare shkeljet e ligjit nenin 61 të LPP-së për operatorin e propozuar për tu shpërblyer me kontratë. Prandaj, ju lutem na dërgoni raportin e vlerësimit ose na krijoni mundësin për qasje ne dokumentacionin e tenderit.

Po të njëjtën datë autoriteti kontraktues i kthen përgjigjeje operatorit ekonomik ankues ku thuhet: Kërkesa e juaj është marr dhe nga ai aspekt është bërë edhe ri vlerësimi. Nga konsultimi me KRPP, rivlerësimi është bërë konform LPP-së, Udhëzuesit për Prokurim Publik pika 28.11, 28.12,28.13,28.14 dhe 18.15. Për kundër, kësaj me qenë se është proces i rivlerësimit mund të bëni kërkesë për rishqyrtim konform nenit 108/A të LPP-së.

Bazuar ne atë që u tha më lartë, ekspertja shqyrtues sqaron se qëndron pretendimi i operatorit ekonomik ankues, për faktin se autoriteti kontraktues nuk i ka lejuar qasje ne dokumentacion të tenderit operatorit ekonomik ankues ashtu si parashihet ne nenin 10 paragrafi 3 të LPP-së, ku thuhet: *autoritetit kontraktues është i obliguar që pas kërkesës me shkrim nga cilado palë e interesit, ti i siguron qasje të arsyeshme palës- operatorit ekonomik ankues që kërkon të ketë qasje në të dhënat e përshkruara në paragrafin 1 dhe 2 të këtij neni, përveç informatave sekrete afariste të cilat vërtetohen si të tilla nga një autoritet përkatës që kanë të bëjnë me çfarëdo aktiviteti të prokurimit që është mbyllur*. Ndërsa, në paragrafin 5 të nenit 10 thuhet: "*Autoriteti kontraktues, me kërkesë të një pale të interesuar, do të bëjë dhe do t'i sigurojë palës së tillë të interesuar një kopje të çfarëdo materiali në të cilin pala e tillë e interesuar ka të drejtë qasjeje sipas paragrafit 3 të këtij neni*".

Pretendimi i operatorit ekonomik ankues ku ndër të tjera thuhet: "*Kalkulimi i çmimit final duke e shumëzuar me 6 është gabim dhe ne kundërshtim me nenin 59 të LPP-së*", ekspertja shqyrtuese bazuar ne raportin e vlerësimit respektivisht të vlerësimit të tri kategorive të peshuar te kriterin për dhënie të kontratës çmim më i ulët i peshuar, sqaron se qëndron pretendimi i operatorit ekonomik ankues, për arsye komisioni i vlerësimit ka llogaritur çmimin total me here (x) 6, ndërsa në dosjen e tenderit te përshkrimi i çmimit është cekur sasia e vlerësuar, çmimi njësi, çmimi total, që rezulton se nuk është cekur që çmimi total do të shumëzohet me 6,

respektivisht se do të bëhen nga 2 servisime brenda vitit gjatë kohë zgjatjes së kontratës ne fjalë.

Bazuar ne atë që u tha më lartë ekspertja shqyrtues sqaron se komisioni i vlerësimit në rastin konkret ka vepruar në kundërshtim me neni 7 paragrafi 6 pika (v) ku thuhet: "asnjë kërkesë, kriter, specifikim që nuk është saktësuar në njoftimin për kontratë dhe dosjes të tenderit, të mos përdoret në procesin e përzgjedhjes ose dhënies".

Pretendimi i operatorit ekonomik ankues ku thuhet se autoriteti kontraktues ka bërë shkelje të nenit 61 të LPP-së, ekspertja shqyrtuese sqaron se nëse krahasohen çmimet e ofruara nga operatorit ekonomik i rekomanduar për dhënie të kontratës (te tabela 2 pozicionet 2.1 deri në 2.6 që janë ofruar me 0.10€ dhe te tabela 3. pozicionet 3.2 deri 3.10, e që janë ofruar me 0.10€), me operatorin ekonomik ankues që ka ofruar çmim për të njëjtat pozicione siç janë 4.00€, 2.00€, 1.00€ apo të OE NPSH "EMERGJENCA" që ka ofruar çmim për të njëjtat pozicione siç janë 4.00€, 3.00€, rezulton se është çmim i ulët, mirëpo ekspertja shqyrtues bazuar në nenin 61 i LPP-së, vlerëson se është drejtë dhe përgjegjësi e autoritetit kontraktues që të konsideron një tender të dorëzuar me çmim jo normalisht të ulët apo jo, që do të thotë se në rastin konkret autoriteti kontraktues respektivisht komisioni i vlerësimit të ofertave, tenderin e dorëzuar nga operatori ekonomik i rekomanduar për dhënie të kontratës nuk e ka vlerësuar si çmim jo normalisht të ulët.

Bazuar ne atë që u tha më lartë ekspertja shqyrtues i rekomandon panelit shqyrtues që ankesa e operatorit ekonomik ankues të aprovohen si bazuara, ndërsa autoriteti kontraktues të anuloj njoftimin për dhënie të kontratës dt. 31 janar 2017, dhe lëndën ta kthej ne Rivlerësim.

Autoriteti kontraktues Komuna e Klinës, përmes parashtresës me shkrim të dt. 02 mars 2017, e njofton panelin shqyrtues se nuk pajtohet ne disa aspekte. Nëse procedura ka pas devijime në përgatitje të kritereve ajo tani më nuk mund të rivlerësohet, pasi rivlerësimi nuk jep rezultate tjera, për faktin që është studiuar detajisht dhe në bazë të kriterit çmimi më i ulët, me poentim nuk del as se si tjetër rezultat, andaj ky proces ose të aprovohet vendimi i autoritetit kontraktues ose ri tenderim sepse tjetër rezultat nuk mund të nxirret.

Operatori ekonomik ankues **"ALBKOS INT" N.T.SH.** me seli në Fushë Kosovë, përmes parashtresës me shkrim të dt. 28 shkurt 2017 , njofton panelin shqyrtues se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues për ta kthyer ne rivlerësimi aktivitetin e prokurimit634/16/073/221, por për arsye parimore nuk pajtohet me sqarimin Nr. 5, që ka të bëjë me Nenin 61- Tenderët Jo-Normalisht të Ulët, pasi që mendojnë së kjo pikë e ankesës kërkon një trajtim më meritor, në të kundërtën nëse lihet si e tillë mund të shërbej si "precedent" për raste të ngjashme.

Me rastin e procedurës para këtij organi u prezantuan provat duke e bërë kontrollimin dhe analizën e materialit të këtij aktiviteti të prokurimit i cili përbëhet: nga autorizimi i këtij aktivitetit, njoftimit për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i rivlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesat e operatorit ekonomik ankues, raporti i ekspertit shqyrtues, i dt. 27 shkurt 2017, si dhe parashtresa e operatorit ekonomik ankues dhe parashtresa e autoriteti kontraktues mbi raportin e ekspertit shqyrtues.

Pretendimi i operatorit ekonomik ankues ku thuhet se autoriteti kontraktues ka bërë shkelje të nenit 10 të LPP-së, paneli shqyrtues bazuar në të gjeturat e ekspertit shqyrtues sqaron se qëndron për faktin se autoriteti kontraktues nuk i ka lejuar qasje ne dokumentacion të tenderit operatorit ekonomik ankues ashtu si parashihet ne nenin 10 paragrafi 3 dhe 5 të LPP-së.

Pretendimi i operatorit ekonomik ankues ku thuhet se autoriteti kontraktues ka bërë shkelje të nenit 59 të LPP-së, paneli shqyrtues bazuar në të gjeturat e ekspertit shqyrtues sqaron se qëndron pretendimi i operatorit ekonomik ankues, për arsye komisioni i vlerësimit ka llogaritur çmimin total me here (x) 6, ndërsa në dosjen e tenderit te përshkrimi i çmimit është cekur sasi vlerësuar, çmimi njësi, çmimi total, që rezulton se nuk është cekur që çmimi total do të shumëzohet me 6, respektivisht se do të bëhen nga 2 servisime brenda vitit gjatë kohë zgjatjes së kontratës ne fjalë.

Andaj, paneli shqyrtues vlerëson se komisioni i vlerësimit në rastin konkret ka vepruar në kundërshtim me neni 7 paragrafi 6 pika (v) ku thuhet: "asnjë kërkesë, kriter, specifikim që nuk është saktësuar në njoftimin për kontratë dhe dosjes të tenderit, të mos përdoret në procesin e përzgjedhjes ose dhënies".

Paneli shqyrtues konstaton se autoriteti kontraktues në dosjen e tenderit respektivisht te Pjesa II-Përshkrimi i çmimit ka specifikuar: sasia e vlerësuar, çmimi njësi dhe çmimi total, duke mos cekur se do të bëhen 2 (dy) servisime brenda vitit gjatë kohë zgjatjes së kontratës, ndërsa komisioni i vlerësimit të ofertave gjatë procesit të vlerësimit të ofertave çmimin total të secilit tenderues e kalkuluar me 6 (gjashtë), edhe pse kjo nuk është specifikuar ne Pjesën II-Përshkrim të çmimit.

Bazuar në nenin 27 të LPP-së dhe nenin 18 pika 4 të Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik-A01, paneli shqyrtues konstaton se autoriteti kontraktues dosjen e tenderit nuk e përgatitur konform neneve të lartë cekura, për arsye se dosja e tenderit duhet të përmbaj të gjitha informatat relevante për kontratës në fjalë, që operatoret ekonomik të interesuar duhet të dinë për përgatitjen e tenderëve pa kërkuar informata shtesë. Çdo fjali në dosjen e tenderit do të konsiderohet mirë, pasi që dosja e tenderit është materiali themelor, në bazë të cilit operatorët ekonomik do të krijojnë tenderët e tyre.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, dosjes se tenderit, konstatimeve të cekura në ekspertizën e ekspertit shqyrtues, shqyrtimit të pikave pretenduese të operatorit ekonomik ankues, parashtresës së operatorit ekonomik ankues të dt. 28 shkurt 2017, parashtresës së autoritetit kontraktues të dt. 02 mars 2017, konstatoj se edhe sikur lënda të kthej në rivlerësim rezultati përfundimtar do të jetë i njëjtë, për faktin se autoriteti kontraktues gjatë hartimit të kërkesave të dosjes së tenderit për aktivitetin e prokurimit me titull: **"Servisimi-mirëmbajtja e aparaturave kundër zjarrit"**, me nr. të prokurimit 634/16/073/221, nuk ka respektuar nenin 27 të LPP-së.

Paneli shqyrtues nga provat e prezantuara më lart, konform nenit: 117 të LPP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendim.

KSHILLA JURIDIKE :

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa,
por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet
Gjykatës Themelore-Departamentit për Çështje Administrative
për kompensim dëmi ne afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit .

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Tefik Sylejmani

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 ekzemplar – OE "ALBKOS INT" N.T.SH. "Fushë Kosovë
1x1 ekzemplar - AK Komuna Klinës
1x1 ekzemplar – Arkivës së OSHP-së